



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice  
Departamenti për Profesione të Lira - Departament Slobodnih Profesija - Department of  
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.16/2024

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore të inicuar sipas ankesës nga [redacted] me seli në [redacted] të cilën e përfaqësojnë [redacted], dhe sipas autorizimit [redacted] si dhe [redacted], kundër Përmbaruesit Privat [redacted], si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted], të cilin e përfaqëson sipas autorizimit [redacted], avokat nga [redacted], rruga " [redacted], lidhur me veprimet përmbarimore të ndërmarra në rastin, P.nr. 415/2024 të datës 19.07.2024, nga Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, raportin për iniciimin e procedurës diciplinore e prezantoi Mimoza Blakaj Zyrtare e Lart Ligjore në Departamentin për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesioneve të Lira dhe Statistika, në seancën e mbajtur me datë 26.12.2024, në praninë e përfaqësuesve të palës propozuesve, Përmbaruesit Privat me përfaqësuesin e tij dhe përfaqësueses nga Departamenti për Profesione të Lira nga Ministria e Drejtësisë, me datë 24.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZHET Raporti për fillimin e procedurës disiplinore i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPSDPLS.nr.16/2024 i datës 10.10.2024, dhe propozimi për iniciimin e procedurës disiplinore i paraqitur nga pala ankuese, [redacted], më te cilën ka kërkuar që Përmbaruesit [redacted], si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted], ti shqiptohet masa disiplinore shkarkim nga detyra, si e pa bazuar.

II. Përmbareuesi si organ përmbareues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, të pretenduara nga propozuesi-pala ankuese , gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbareimore P.nr. 415/2024 të datës 19.07.2024, me titull përmbareimor Vendimi i Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), me nr. 24841/MHM/HHB i datës 18.02.2022.

### A r s y e t i m

#### *Pretendimet e propozuesit të procedurës disiplinore*

Me datën 10.10.2024, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë, ndaj Përmbareuesit Privat, me propozim për iniciimin e procedurës disiplinore, duke pretenduar se përmbareuesi privat, me rastin e marrjes së veprimeve përmbareimore të P.nr. 415/2024 i datës 19.07.2024, me titull përmbareimor Vendimi i Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), me nr. 24841/MHM/HHB i datës 18.02.2022, ka bërë shkelje të nenit 367, paragrafi 1 nën paragrafët 1, 12 të Ligjit të Procedurës Përmbareimore (LPP). Propozuesi pretendoi se përmbareuesi privat ka qenë i njoftuar nga debitori me rastin e ndërmarrjeve të veprimeve përmbareimore, në rastin e cekur më lart, se ka rrezikuar besimin në anshmerinë e tij ka, bërë tejkalim të besuar me ligj dhe nuk iu është përmbajtur ligjit me rastin e ndërmarrjeve të veprimeve përmbareimore. Rrezikimi i besimit në anshmerinë vjen në shprehje kur përmbareuesi menjëherë pas aktvendimit për refuzimin e prapësimit, KPPP.nr.1137/2024 të datës 03.10.2024, të Gjykatës Komerciale, brenda një ore nga pranimi i të njëjtit nga pala kreditore, e ka bërë bllokimin e llogarive bankare të debitorit, të cilat veprime i ka bërë sipas instruksioneve nga kreditori, duke mos i dhënë mundësi debitorit të përgjigjet nëse është i gatshëm që ta përmbushë këtë obligim dhe duke mos i dhënë asnjë mundësi të deklarimit të debitorit, i cili përmbareues në cilësinë e organit përmbareues do të duhej të tentoi që të gjej zgjidhje, para se të merren veprime përmbareimore.

Debitori posa ka pranuar aktvendimin, KPPP.nr.1137/2024 të datës 03.10.2024, të Gjykatës Komerciale, ka parashtruar kërkesën për shtyrjen e përmbairmit dhe përmbareuesi lëndor e ka refuzuar kërkesën e debitorit, duke mos e dëshmuar refuzimin në harmoni me dispozitat ligjore nga nenin 61 i LPP-së.

Pala ankuese më tutje ka theksuar se gjykatës i është parashtruar kërkesa për anulim të vendimit të arbitrazhit, i cili fakt do të duhej të shërbente si shkak për shtyrjen e përmbairmit, e cila kërkesëpadi është në pritje për tu vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës, sipas revizionit. Mirëpo përmbareuesi edhe pas të gjitha këtyre njoftimeve , me veprimet e tij përmbareimore tejkaloi kompetencat ligjore të tij, pasi që i njëjti ka arsyetuar se procedura e lart cituar ka përfunduar dhe

nuk kemi të bëjmë me çështje paraprake, e që do të mund të shërbente si arsye për ndërprejje të procedurës. I ka propozuar Komisionit, që të aprovohet propozimi për iniciimin e procedurës disiplinore dhe përmbaruesit privat ti shqiptohet masa disiplinore shkarkim nga detyra.

Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesioneve të Lira dhe Statistika, në Ministrinë e Drejtësisë, me datë 10.10.2024, ka hartuar Raportin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat DPSDPLS.nr.16/2024 i datës 10.10.2024, i cili edhe është prezantuar në seancën dëgjimore të datës 26.12.2024, nga Mimoza Blakaj, zyrtare e lart ligjore në Departamentin për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika, pranë të cilit raport ka mbetur edhe në seancën e datës së lartcekur.

#### *Pretendimet e Përmbaruesit Privat, palë në këtë procedurë*

Përmbaruesi Privat, përmes përfaqësuesit të tij, si në përgjigjen e tij si dhe në seancën e mbajtur ashtu edhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar raportin për iniciimin e procedurës disiplinore të Departamentit për Profesione të Lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbarim Privat, në Ministrinë e Drejtësisë, dhe propozimin për iniciimin e procedurës nga pala ankuese. Më tutje përmbaruesi ka deklaruar se asnjë veprim i ndërmarrë me rastin e procedimit të rastit , nuk është në kundërshtim me ligjin. Ankesa e debitorit nuk paraqet asgjë më shumë, përpos një përpjekje për zvarritje të procedurës përmbarimore dhe dëmtim të përmbaruesit privat.

Propozimi për përmbarim është parashtruar me datën 19.08.2024, bazuar në nenin 22, par.1.5 të LPP-së. Dokument përmbarimor në këtë rast ka qenë vendimi i arbitrazhit i cili vendim është njohur dhe është shpallur i ekzekutueshëm me vendim të gjykatës.

Debitori ka parashtruar prapësim me dt.26.08.2024, në prapësim ka potencuar se dokumenti përmbarimor mund të prishet , anulohet apo shfuqizohet në ndonjë mënyrë tjetër, pasi që ekziston padia për anulim të vendimit të arbitrazhit .

Me datën 02.10.2024, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar prapësimin dhe ka mbetur në fuqi urdhëri përmbarimor, P.nr.415/24 i datës 19.08.2024. Sipas gjykatës dokumenti përmbarimor është dokument që i plotëson kriteret për të qenë dokument përmbarimor. Gjykata ka vlerësuar se revizioni i paraqitur nga debitori nuk është pengesë për përmbarim dhe kërkesa bazuar në këtë dokument është në harmoni me dispozitat e nenit 38 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Për pretendimet e debitorit lidhur me tejkalimin e autoritetit ligjor, i autorizuari i përmbaruesit privat ka theksuar se është i pa themeltë si në bazë faktike ashtu edhe ligjore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, analizimit të dispozitës së cituar më lart, Komisioni Disiplinor, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe provat shkresore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim që Përmbartuesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, për këto arsye:

#### *Baza ligjore për shkelje disiplinore*

Neni 367 paragrafi 1 pikat nga 1 deri 11, i Ligjit të Procedurës Përmbartimore, i përcakton shkeljet përmbartimore për përmbartuesit privat, si janë në vijim:

- 1.1. Nëse përmbartuesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;
- 1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbartuesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 1.3. Nëse përmbartuesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. Nëse përmbartuesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;
- 1.5. Nëse përmbartuesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. Nëse përmbartuesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;
- 1.7. Nëse përmbartuesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. Nëse përmbartuesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;
- 1.9. Nëse përmbartuesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbartimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 1.10. Shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera dhe
- 1.11. Nëse përmbartuesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

#### *Çështjet kontestuese dhe jo kontestuese në këtë rast disiplinor*

Nuk është kontestuese në mes palëve në procedurë dhe për komisionin disiplinor, se përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin, në bazë të Vendimit të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), me nr. 24841/MHM/HBH të datës 18.02.2022.

Nuk është kontestuese se kreditori dhe debitori, në këtë procedurë debitori është propozues i procedurës disiplinore, me datë 24.05.2017, kanë arritur marrëveshje për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit, nr. 20990/MHM të datës 09.12.2016.

Kontestuese midis palëve mbetën veprimet e ndërmarra të përmbartuesit privat në çështjen përmbartimore P.nr.415/24 të datës 19.08.2024, për sa i përket ndërmarrjes së veprimeve

përmbartimore, pasi që përmbartuesi privat është njoftuar me kërkesën e debitorit lidhur me shtyrjen e përmbartimit.

#### *Vlerësimi përfundimtar i Komisionit Disiplinor për Përmbartues Privat*

Komisioni është lëshuar në vlerësimin e pretendimeve ankimore të inicuesit të procedurës disiplinore, vetëm sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me marrjen e veprimeve përmbartimore të përmbartuesit privat në rastin lëndor. Komisioni vlerëson se nuk është shkelje disiplinore e përmbartuesit privat me rastin e ndërmarrjeve të veprimeve përmbartimore, siç u konstatua më lart, ngase përmbartuesi privat vetëm ka lejuar dhe ka ndërmarrë veprime përmbartimore konform dokumentit përmbartimor që në këtë rast është Vendimi i Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), më nr. 24841/MHM/HBH i datës 18.02.2022, i njohur dhe i shpallur dhe i ekzekutueshëm nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Ekonomike K.E.Nr.2142/2022 datë 08.07.2024, të cilat veprime të përmbartuesit privat janë konform dispozitave të LPP-së.

Komisioni Vlerëson se veprimet e përmbartuesit privat, janë ndërmarrë pasi që urdhri për lejimin e përmbartimit është i bërë i përmbartueshëm sikurse parashihet me dispozitat ligjore, pasi prapësimi i debitorit është refuzuar me vendim të gjykatës dhe janë plotësuar kushtet ligjore për veprimet e mëtejme përmbartimore, siç me të drejtë i ka ndërmarrë veprime përmbartuesi privat në rastin konkret.

Pretendimi i palës ankuese se përmbartuesi nuk ka dhënë hapësirë për deklaram nga pala debitore, përkundër që nuk është pengesë ligjore për të vepruar pa këtë deklaram, komisioni e vlerëson si të pabazuar, sepse nga shkresat e lëndës rezulton se përmbartuesi privat ka lënë një hapësirë kohore 2 apo 3 orë, nga momenti i pranimit të vendimit të gjykatës deri në ndërmarrjen e veprimeve përmbartimore, respektivisht bllokimin e llogarive edhe pse i njëjti ka mundur që mënjëherë të ndërmerr veprime përmbartimore. Kjo nga shkaku se me asnjë dispozitë ligjore të LPP-së, nuk është përcaktuar se sa kohë duhet të pret përmbartuesi privat për marrjen e veprimeve përmbartimore, pasi që të merret vendim nga gjykata sipas prapësimi të këto natyra të rasteve. Andaj, edhe ky pretendim i propozuesit të inicuesit të procedurës disiplinore është në tërësi i pabazuar.

Komisioni e vlerësoi pretendimin e debitorit – inicuesit të procedurës disiplinore lidhur me paraqitjen e padisë për sa i përket anulimit të vendimit të arbitrazhit mbi të cilin është lejuar përmbartimit në këtë rast. Mirëpo, vlerësoi se edhe ky pretendim i debitorit – inicuesit të kësaj procedure, është i pabazuar sepse nuk është shkak i pezullimit, shtyrjes apo ndërprejjes së kësaj

procedure përmbarimore paraqitja e padisë siç pretendon debitori, pasi në rastin lëndor këmi të bëjmë me vendim të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm si dokument përmbarimor dhe në këtë procedurë ashtu siç është vlerësuar dhe lejuar përmbarimi nga përmbaruesi privat më të drejtë, nuk mund të vlerësohen rrethanat tjera kontestuese siç janë pretendimet me padi, pasi që siç dihet procedura përmbarimore është procedurë formale dhe rigoroze që mbështetet vetëm në vlerësimin e dokumenteve mbi të cilat lejohet përmbarimi, prandaj në këtë rast edhe ky pretendim i debitorit është në tërësi i pabazuar.

Pretendimin e debitorit se në këtë procedurë mund të ketë konflikt interesi të përmbaruesit privat pasi që në trajtimin e padisë për anulim të vendimit të arbitrazhit në vendimmarrje ka qenë gjyqtarja e cila është motra e përmbaruesit, komisioni në këtë rast nuk mund ta vlerëson këtë pretendim, pasi që nuk është në juridikisionin e komisionit dhe për më tepër pasi që kemi të bëjmë me një procedurë tjetër sipas padisë. Kërkesën për përjashtim eventuale të përmbaruesit për çështjen përmbarimore për shkak të konfliktit eventuale të interesit e vlerëson dhe vendos gjykata e jo komisioni disiplinor.

Nga interpretimi i dispozitave të lartcekura ligjore dhe nga arsyet e dhëna si më lart Komisioni Disiplinor, erdhi në përfundim se përmbaruesi privat më asnjë nga veprimet e tij përmbarimore, deri në marrjen e këtij vendimi, nuk ka bërë asnjë shkeljeve disiplinore, sepse të gjitha parregullsitë e pretenduara për çështjen përmbarimore në fjalë, nga propozuesi i kësaj procedure janë vendosur dhe evituar me aktvendimet e lartcekura të gjykatave. Andaj Komisioni Disiplinor vlerëson se Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet e lartcituara disiplinore, të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, siç pretendon propozuesi.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në dispozitat ligjore 361 paragrafi 2 lidhur me nenin 374 të LPP-së.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT  
DPSDPLS.nr.16/2024 datë 24.01.2025

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor  
Manushe Karaçi

*KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ, bazuar në nenin 374 par. 5 të LPP-së.*

